

## SYLLABUS PËR LËNDËN MIKROEKONOMIA

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik		
Titulli i lëndës:	Makroekonomia		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I pare		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:			
Detajet kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës			
Përshkrimi i lëndës	Lënda ka të bëjë me konceptet kyç të makroekonomisë, sikurse janë bruto produkti vendor (GDP), punësimi dhe papunësia, inflacioni, rritja ekonomike, ciklet e biznesit dhe bilanci i pagesave si edhe me instrumentet politike dhe të analizës makroekonomike.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me konceptet kyç të makroekonomisë në mënyrë që të mund të kuptojnë rrjedhat e zhvillimit ekonomik në vend dhe në botë		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. të njoh çka studjon shkenca e makroekonomisë</li> <li>2. të njoh konceptet kyç të makroekonomisë</li> <li>3. të kupton më mirë rrjedhat e zhvillimit ekonomik në vend,</li> <li>4. të analizojë treguesit kryesorë makroekonomik si dhe të bëjë krahasimin e këtyre treguesve të vendit me vendet tjera.</li> </ol>		
Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me	1	1	1

mësimdhënës/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj	3	5	15
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
	Ligjërata, diskutim, prezentim i punimeve seminarike.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	Kollokiumi i parë: 45% Kollokiumi i dytë : 45% Nota përfundimtare formohet duke pasur parasysh edhe: Punim seminarik 10% <b>Totali 100%</b>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje në ekonomi		
<b>Literatura shtesë:</b>	1. Musa Limani, Hyrje në ekonomi, Prishtinë, 2002 2.N.Gregory Mankiw, Macroeconomics, Harward University, Worth Publishes, New York, 2004 3. Paul Samuelson, William Nordhaus, Economics, International Student Edition, USA, 2002 4. www.bqk-kos.org 5. <a href="http://www.mfe-ks.org">www.mfe-ks.org</a> 6.www.ask-kos.org		
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>			
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>		
<b>Java e parë:</b>	Vështrim i përgjithshëm mbi makroekonominë, Konceptet kryesore të makroekonomisë,		
<b>Java e dytë:</b>	Objektivat kryesore makroekonomike dhe mjetet politike të		

	realizimit të tyre, Instrumentet kryesore të analizës makroekonomike
<b>Java e tretë:</b>	Matja e produktit të përgjithshëm, Mënyra e prodhimit, Mënyra e shpenzimeve, Mënyra e të ardhurave, Konsumimi i kapitalit, Disa identitete të rëndësishme makroekonomike, Produkti kombëtar dhe mirëqenia ekonomike
<b>Java e katërt:</b>	Kërkesa agregate dhe faktorët përcaktues të saj, Oferta agregate në periudha afatshkurtëra, Oferta agregate në periudha afatgjata, Ekuilibri makroekonomik (Modeli klasik dhe kejsian)
<b>Java e pestë:</b>	Konsumi dhe kursimi, Të ardhurat e disponueshme dhe funksioni i konsumit, Faktorë të tjerë përcaktues të konsumit, Investimet dhe norma e interesit, Teoria e akseleratorit
<b>Java e gjashtë:</b>	Shpenzimet agregate dhe GDP real, Investimet dhe kursimi, Multiplikatori i shpenzimeve Multiplikatori i politikës fiskale, Multiplikatori i taksave, Multiplikatori i ekonomisë së hapur, Cikli i biznesit dhe fazat e tij
<b>Java e shtatë:</b>	Hendeku i prodhimit në modelin kejsian, Hendeku i prodhimit në modelin klasik, Disa teori të cikleve të biznesit, Rritja ekonomike, Rritja ekonomike dhe funksioni i prodhimit, Kuptimi i inflacionit, Llojet e inflacionit, Kostot e inflacionit
<b>Java e tetë:</b>	Papunesia, Matja e papunesisë dhe kostot e saj, Interpretimi ekonomik i papunesisë dhe llojet e saj, Papunesia e vullnetshme, Papunesia e detyruar
<b>Java e nëntë:</b>	Norma natyrore e papunesisë, Raporti papunesi – inflacion, Burimet e inflacionit, Kurba e Philipsit, Kurba e Philipsit në periudha afatgjata
<b>Java e dhjetë:</b>	Paraja dhe sistemi bankar, Paraja dhe funksionet e saj, Komponentet e ofertes monetare dhe kërkesa për para Bankat, llojet e tyre dhe procesi e krijimit të parase, Shumefishimi i parase
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Banka Qendrore, Funksionet e Bankes Qendrore dhe instrumentet e politikës monetare, Instrumentet direkte dhe indirekte të politikës monetare
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Tregu monetar dhe mekanizmi i politikës monetare, Motivet e mbajtjes së parase, Mekanizmi i transmissioinit të politikës monetare, Rryma monetariste dhe veçoritë e saj

<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Politika fiskale, Buxheti qeveritar dhe politika fiskale, Llojet e politikës fiskale
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Stabilizatorët kryesorë automatikë në kuadrin e sistemit fiskal, Nderveprimet e politikave monetare dhe fiskale, Pasojat ekonomike të borxhit qeveritar
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Marredhëniet ekonomike ndërkombëtare, Tregëtia ndërkombëtare, faktorët që e përcaktojnë dhe ekuilibri në tregun ndërkombëtar, Bilanci i pagesave, tregu valutor dhe kurset e këmbimit

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrimet, Rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë